

Gjykata Supreme e Kosovës, kolegji i përberë nga gjyqtaret: Enver Peci, kryetar, Erdogan Haxhibeqiri dhe Emine Kaçiku anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, si procesmbajtës, në konfliktin administrativ të paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr.271/2016 të datës 18.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 22.02.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e bazuar kërkesa e paditëses, Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a në Prishtinë , për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, AA.nr.271/2016 të datës 18.10.2016, si dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative A.nr. 1734/2013 datë 27.06.2016, kurse lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë për në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AA.nr.271/2016 të datës 18.10.2016 është refuzuar si e pa bazuar ankesa e të paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative , A.nr. 1734/2013 datë 27.06.2016 është vërtetuar.

Paditësi kësaj gjykate në afat ligjor i ka parashtrua kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë, me të cilën në tërësi e konteston ligjshmërinë e

aktgjytimeve të atakuar të gjykatave të instancave më të ulëta pa specifikuar shkeljen konkrete por me kërkesë që të rishikohen aktgjykimet dhe të shfuqizohen, pasi që e gjithë procedura dhe vendimet e atakuara kanë mbet pa materie për faktin se baza juridike e tyre është prishur me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gj. Th. Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1440/13 i dt. 09.06.2016.

Gjykata Supreme e Kosovës në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktvendimit të atakuar, kërkesës së paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë dhe shqyrtimit të shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Kërkesë është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë çështje juridike administrative sipas vendimit të paditurës, Nr.2378 datë 29.07.2013, është aprovuar ankesa e F. A., si e bazuar dhe është obliguar paditësi që në afat prej 8 ditësh t'i ndërmerr veprimet të përcaktuara në pikën 5- të Kontratës së punës nr. 5946/0 datë 08.05.2013, të F. A., pastaj ta ndryshoj vlerën e pagës bazë nga 520.00 Euro, me vlerën e pagës bazë 822.00 Euro, me obligim që paditësja në rast mos eliminimit të parregullsive do të veprohet në bazë të dispozitës së nenit 92 paragrafi 1 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212. Vendimi në fjale i shkallës së parë i të paditurës, me vendimin e shkallës së dytë, nr. 63/2013 datë 03.09.2013, ka refuzuar ankesën e të paditurës dhe e ka vërtetuar vendimin e shkallës së parë. Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, sipas padisë së paditësit ka zhvilluar konflikt administrativ njashtu që; me aktgjykimin A.nr.1440/13 datë 09.06.2016, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka anuluar vendimin e të paditurës njëherit lenden e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje të e paditura, sipas aktgjykimit të bashkangjitur në kërkesë i njëjti është i plotfuqishëm nga data 14.09.2016.

Më tutje e paditura me vendimin 01-nr.08-93/2013 datë 28.10.2013, paditëses i është shqiptuar masa ndëshkuese gjore në shumë prej 2.000,00 Euro, ndërsa me vendimin e shkallës së dytë nr.81/2013 datë 27.11.2013, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditëses dhe është vërtetuar vendimi i shkallës së parë.

Paditësi me padi për këtë pjesë hap konflikt administrativ të veçant nga rasti i përshkruar më lartë, me ç'rast Gjykata Themelore në Prishtinë me aktgjykimin A.nr.1734/13 datë 27.06.2016, e refuzon si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses ndërsa Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin AA.nr.271/2016 datë 18.10.2016 e refuzon ankesën dhe e vërteton aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, bazuar në shkresat e lëndës konstatoj se kjo çështje konkrete administrative ka pas dy procedura të ndara administrative. Fillimisht siç u cek nga shkresat e lëndës me vendimin e të paditurës është aprovuar ankesa e F. A., që paditësi në afat prej 8 ditësh t'i ndërmarr veprimet e përshkruara më lartë, me ç'rast ky vendim i organit administrativ i shkallës së parë sipas ankesës së paditëses vërtetohet me vendimin e shkallës së dytë të paditurës. Për këtë pjesë fillohet konflikt administrativ sipas padisë së paditësit, njashtu që siç u potencua më lartë Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative me aktgjykimin e cekur e aprovon kërkesëpadinë e paditëses dhe e anulon vendimin e të paditurës ndërsa lëndën e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kësisoj, me dispozitën e nenit 65 të LKA-ës, është parapa që kur gjykata anulon aktin kundër të cilit ka filluar konflikti administrativ, lënda kthehet në gjendjen në të cilin ishte para se të ishte nxjerrët akti i anuluar, mes tjerash më tutje kjo dispozitë e obligon organin administrativ që duhet në vend të aktit të anuluar administrativ të nxjerr një tjetër dhe këtë pa shtyrje e jo më vonë se 30 ditë. Në një situatë të tillë procedurale meqenëse Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin A.nr.1440/13 datë 09.06 2016, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka anuluar vendimin e të paditurës njëhërit lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje te e paditura, duke pas parasysh se me këtë aktgjykim është anuluar baza e aktit administrativ me të cilin e paditura ka gjetur parregullsi tek paditësi.

Meqenëse me këtë aktgjykim është anuluar Vendimi i të paditurës Nr.63/2013 të dt. 03.09.2013 ndërsa sipas gjykatës këto parregullsi të paditësit janë anuluar dhe është dashtë të nxjerrët akt i ri administrativ sipas vërejtjeve te gjykatës nga e paditura, kjo gjykatë konstatoj se procedura e zhvilluar sipas padis së re me të cilën sipas vendimit të paditësit 01 Nr. 08-93/13 i dt.28.10.2013, me të cilin është vërtetuar vendimi i shkallës së parë të paditurës me të cilin është shqiptuar gjoba për parregullsitë e procedurës

paraprake është jo lëndore. Kësisoj, edhe aktgjykimet e atakuara të gjykatave të instancave më të ulëta me të cilat janë vërtetuar vendimet e kontestura të paditurës janë në kundërshtim me gjitha rregullat e procedurës.

Duke vlerësuar arsyrat e mësipërme, Gjykata Supreme e Kosovës nuk mundë të pranoj si të drejt qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit në Prishtinë dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, sa i përket aktgjykimeve të kontestuar, për shkak se të njëjti janë përfshirë me shkelej substanciale të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore i aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA –ës, të cilat shkelje drejtpërdrejt kanë pas ndikim në marrjen e vendimit të ligjshëm, andaj aktgjykimet e atakuara doemos është dashur të anulohen.

Gjykata e shkallës së parë ka për detyrë që, në procedurën e përsëritur, të mënjanoj të metat e sipërpërmendura, ashtu që së pari duhet siguroj shkresat e lëndës A.nr.440/13 në mënyrë që të vërtetoj se e paditura a ka veprua sipas aktgjykimit të anuluar në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura në kuptim të nenit 65 të LKA-ës, të karakterit të detyrueshëm të aktgjykimit, pastaj të administroj provat në shkresat e lëndës dhe varësisht nga gjendja faktike e vërtetuar, me zbatimin adekuat të së drejtës materiale të vendos rreth kësaj çështje juridike-administrative, në mënyrë që të marr vendim të drejt dhe të bazuar ne ligje.

Nga sa u tha me sipër, Gjykata Supreme e Kosovës me zbatimin e nenit 54 par.2 dhe 3 të Ligjit për Konflikte Administrative vendosi sikur në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Më 22 shkurt 2017, ARJ.nr.41/2016

Procesmbajtësi,
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,
Enver Peci